



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË

V E N D I M

Nr. 69, datë 06.12.2007

**“MBI MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTEVE ME
SIPËRFAQE 200-500 M² TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE NË
ADMINISTRIM TË BASHKISË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, neni 32, gërma "e", "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", V.K.M. Nr. 378, datë 12.08.1999 "Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", pika 1, V.K.M , Nr.162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe të institucioneve shtetërore", kapitulli I, pika 4/b, pika 7/b , kapitulli II, Udhëzimit Nr.562, datë 15.08.2007, Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.162, datë 07.03.2007 " Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe istitucioneve shtetërore", pika 8 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të objekteve me sipërfaqe 200-500 m² për një periudhë 5 vjeçare, në juridiksionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës si më poshtë:

Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve

Objekti - Salla e mbledhjes dhe ish qendra e zërit

Sip salla e mbledhjeve	Sip	243.1 m ²
Sip katit parëqendra e zërit	Sip	35 m ²
Sip funksionale	Sip	97 m ²

Sip totale

375.1 m²

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij në mbështetje të kapitullit II të V.K.M Nr.162, datë 07.03.2007.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit të Aseteve si dhe ndërmarrja Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol Dervishaj

K R Y E T A R